



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:260886

Datë: 01.03.2024

Numri i dokumentit: 05401181

**C-IV-14-2183**

*Ankuesja*

**Z V, fshati B, Kamenicë.**

**Kundër:**

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Driton Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.**

**Për: Palët**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 01 mars 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

1. **REFUZOHET** si e pa bazuar Ankesa dhe **VERTETOHET** Vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI045-0070, i datës 28 shkurt 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
2. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.

**Rrethanat Faktike dhe Procedurale**

Me 27 mars 2014, ankuesja (nëpërmjet postës) dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër vendimit nr. GJI045-0070 i datës 28 shkurt 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e saj për kompensim për paga të papaguara në shumë prej 900.00 € për periudhën kohore maj – korrik 2006 nga NSH “XIQ Karaqeva” (në likuidim). Ankuesja theksoi se duke qenë se ishte punonjëse e kësaj NSH-je dhe ka marr 20% nga privatizimi i ndërmarrjes, ndaj kësaj NSH-je ka disa kërkesa si në vijim. Kompensimin për 3 (tre) paga të papaguara bazuar në ligjin e AKP-së nr.03/L-034 neni 40.1.6.1 ku është paraparë që në tre (3) pagat e papaguara të punëtorëve prioritet, ku janë prioritet më i lartë. Llogaritur  $3 \times 300.00 \text{ €} = 900.00 \text{ €}$ . Me 15 gusht 2006 ka marr një njoftim zyrtar nga zyra rajonale e AKP-së në Gjilan se punësimi juaj ndërpritet menjëherë. Në të njëjtin memorandum, paragrafi 3 thotë: *Të gjitha shumat e parave, duke përfshirë të ardhurat personale të papaguara, të cilat punëdhënësi ju detyrohet sipas kontratës suaj të marrëdhënies së punës, do të mbeten përgjegjësi e punëdhënësit tuaj. Këto pretendime do të zgjidhen brenda procedurës së likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë ato procedura.* Me këtë, AKP na ka lënë në pritje që kërkesat tona të shqyrtohen në

procesin e likuidimit. Prandaj nuk na është dhënë asnjë udhëzim ligjor në lidhje me kufizimin e afatit të aplikimit sipas Ligjit nr.04/L-034 për AKP-në, gjegjësisht sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 skadon brenda tre (3) viteve. Prandaj, me njoftimin e datës 15 gusht 2006, AKP-ja pa fajin tonë na ka zhgënjyer. Ankuesja i propozon gjykatës që vendimin e AL ta anuloj dhe të mundëson pagesën e pagave në bazë të ligjit të AKP-së nr.03/L-034. Ankuesja në mbështetje të ankesës së saj ka bashkangjitur dëshmitë në kopje si: Vendimin e kundërshtuar dhe Njoftimin për përfundimin e punësimit lëshuar për ankuesen nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) datë 15 gusht 2006.

Me 18 qershor 2019, e paditura AKP parashtroi mbrojtjen e saj në të cilën pohon se AL si përfaqësuese ligjore e të paditurës NSH “XIQ Karaqeva” Kamenicë (në likuidim), i kundërshton të gjitha pretendimet e ankueses të paraqitura në ankesën e saj, duke i konsideruar si të pabazuara në ligj dhe si e tillë duhet të refuzohet. Ankesa e ankueses nuk përmban bazën ligjore dhe asnjë listë të provave mbi të cilën do ta mbështeste propozimin e saj, andaj propozimi i saj nuk i përmban të gjitha elementet që parashihen me nenin 27 pika 2.4 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L033 për DHPGJS si dhe nenin 253 të Ligjit për Procedurë Kontestimore (LPK) Nr.03/L-006. Ankuesi nuk ka prezantuar fakte në kuptim të nenit 7 të LPK-së, ku theksohet se: *“Palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. Në procedurën e likuidimit ankuesja kishte parashtruar kërkesë kreditore për kompensimin e pagave të papaguara në shumë prej 900.00 € nga NSH “XIQ Karaqeva” Kamenicë (në likuidim). Autoriteti i Likuidimit (AL) me datë 28 shkurt 2014, ka vendosur për refuzimin e kërkesës së ankuesit me vendimin nr. GJI045-0070. Ankuesja ka dështuar që të argumentoj se cilat janë shkeljet ligjore apo shkaqet procedurale të cilat sipas vlerësimit të saj AL ka bërë lëshime gjatë vlerësimit të kërkesës së saj kreditore. Pala nuk ka ofruar asnjë provë të re materiale me të cilën dëshmon të kundërtën nga ajo sa është vendosur me vendimin e AL. Përfundimet e ankueses janë tërësisht të gabueshme për faktin sepse kërkesa e saj është shqyrtuar në përputhje me ligjin material sipas objektit të kërkesës dhe se nuk ka se si të vendosej ndryshe. Agjencia mbështet vendimin e AL mbi bazën e arsytimit të refuzimit të kërkesës duke u bazuar se AL ka bërë shqyrtimin e meritave tjera të kërkesës dhe është konstatuar se kjo kërkesë në bazë të LPB (GZ nr.53, viti 1976) përkatësisht nenit 608 të këtij ligji, ishte parashkruar e drejta e saj për kompensimin e pagave për në emër të dëmshpërblimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. AL nuk ka gjetur ndonjë provë me anë të së cilës shihet se ankuesja kishte iniciuar ndonjë procedurë gjyqësore pranë gjykatave apo organit kompetent për realizimin e kërkesës. Pra ankuesja nuk ka dëshmi se me ndonjë procedurë e ka ndërprerë rrjedhën e këtij afati. Nga të cekurat më lartë, e paditura i propozon gjykatës që pas shqyrtimit të provave dhe thënieve nga e paditura të refuzoj si të pabazuar ankesën e ankuesit dhe të vërtetoj vendimin e AL si të drejtë dhe të ligjshëm si dhe të obligohet ankuesi që të kompensoj të gjitha shpenzimet procedurale.

Me 06 dhjetor 2023, gjykata lëshoi urdhër për ankuesen përmes së cilit kërkoi nga e njëjta që të precizoj dhe plotësoj ankesën e saj dhe të dorëzoj prova relevante në mbështetje të saj. Me 26 dhjetor 2023, urdhri u pranua nga ankuesja dhe asnjë përgjigje nuk u dorëzua.

Për detaje të tjera, referimi mund të bëhet tek dosja e lëndës.

## **Arsyetimi Ligjor**

Ankesa refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL si i drejt dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrirat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Gjykata vlerëson se kërkesa e ankueses për kompensim për paga të papaguara në shumë prej 900.00 € për periudhën kohore maj – korrik 2006 nga NSH “XIQ Karaqeva” (*në likuidim*), nuk është e mbështetur në prova dhe si e tillë është e pabazuar. Ankuesja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante në procedurë të likuidimit, por as në kohën e parashtrimit të ankesës në gjykatë kundër vendimit të AL, me të cilat do të mund të dëshmonte se ka ofruar shërbime/punë për NSH dhe se NSH detyrohet për kompensimin e pagave të pretenduara. E vetmja dëshmi e dorëzuar nga ankuesja në këtë rast është njoftimi për përfundimin e punësimit lëshuar nga AKM datë 15 gusht 2006, e cila si e tillë nuk mbështet pretendimet e saj për paga të papaguara eventualisht të mbetura borxh nga NSH-ja. Ankuesja vetëm e ka caktuar periudhën për të cilën kërkon pagat. Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankueses lidhur me të drejtën e saj në kompensim për paga të papaguara nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si e tillë kërkesa për paga është refuzuar si e pabazuar. Për më tepër ankuesja ka dështuar që të parashtronte prova në mbështetje të kërkesës së saj edhe pas urdhrin të gjykatës.

Kërkesën për tre (3) paga të papaguara në shumë prej 900.00 €, gjykata e gjen si të pabazuar edhe për faktin se Shtojca e Ligjit për AKP-në (nr. 04/L-034), neni 40.1.6.1, i referohet vetëm prioritetit të tre (3) pagave të fundit të papaguara. Prioriteti i lartë megjithatë nuk ia njeh

automatikisht të drejtën e punëtorit për tri pagat, por i jep prioritet në mesin e borxheve të tri pagave të fundit të cilat mund të kenë mbetur pa u paguar.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Shpenzimet gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, nuk caktohen taksat gjyqësore, në këtë procedurë ankimore, pasi që vlera e objektit të kontestit është nën 1,000 €.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga data e pranimit. Ankesa duhet të parashtrohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli  
Gjyqtar